

URDHËR
Nr. 1047, datë 2.12.2024

**PËR RIPËRTËRITJEN E LICENCËS SË SHOQATËS “AGJENCIA E
ADMINISTRIMIT KOLEKTIV TË TË DREJTAVE TË AUTORËVE (ALBAUTOR)” SI
AGJENCI E ADMINISTRIMIT KOLEKTIV NË FUSHËN E TË DREJTAVE TË
AUTORIT PËR VEPRAT LETRARE, ARTISTIKE DHE SHKENCORE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar, vendimit nr. 33, datë 1.1.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria e së Drejtës së Autorit”, si dhe udhëzimit nr. 338, datë 2.6.2023, të ministrit përgjegjës për të drejtat e autorit, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës”,

URDHËROJ:

1. Ripërtëritjen e licencës për subjektin ALBAUTOR, shoqatë e regjistruar me vendimin nr. 578, datë 18.2.1998, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me NIPT: J81512003D, si agjenci e administrimit kolektiv të të drejtave të autorit në çdo krijim intelektual origjinal në fushën e letërsisë, artit dhe shkencës, përveçse administrimin kolektiv të të drejtave të autorit të krijimeve audiovizuale, në të cilat përfshihen edhe krijimet kinematografike.
2. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë si agjenci e administrimit kolektiv është e vlefshme për 3 (tre) vjet, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
3. Ngarkohet Drejtoria për të Drejtën e Autorit për njoftimin e këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Blendi Gonxhja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
MINISTRI

Nr. 3993/Prot.,
13

Tiranë, më 30. 8.2021

URDHËR

Nr. 547, datë 30. 8.2021

**“PËR RIPËRTËRITJEN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ALBAUTOR” NË
ADMINISTRIMIN KOLEKTIV NË FUSHËN E TË DREJTAVE TË AUTORIT PËR
PËR VEPRAT MUZIKORE ME APO PA TEKST”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 134, 135, 157 dhe 158 të ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, udhëzimit nr. 385, datë 13.10.2020 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, si dhe legjislacionit në fuqi “Për Organizatat Jo-fitimprurëse”:

U R D H Ë R O J:

1. Ripërtëritjen e licencës së shoqërisë “Albautor” si agjenci e administrimit kolektiv në fushën e të drejtave të autorëve për veprat muzikore me apo pa tekst.
2. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë si agjenci e administrimit kolektiv është e vlefshme për 3 (tre) vjet, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
3. Ngarkohet Drejtoria e të Drejtës së Autorit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E KULTURËS

LICENCË

NR. 1 DATË 06 10 2018

Në mbështetje të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, udhëzimit nr. 5166, datë 20.10.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të tjera shtesë në sqarim të kriterëve të parashikuara në nenin 133, si dhe përcaktimin e kushteve dhe procedurës së marrjes së licencës ose ripërtëritjen e saj, në bazë të nenit 134, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, Vendimit nr. 33, datë 18.1.2017 “Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit”, Ministri i Kulturës pasi konstatoi se dokumentacioni i paraqitur nga Agjencia “ALBAUTOR” është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to,

VENDOSI:

Të licencojë subjektin ALBAUTOR

Si agjenci e administrimit kolektiv të të drejtave të autorëve të veprave artistike dhe letrare.

Njohur si person juridik me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 578 datë 18.2.1998, i ndryshuar

Person i tatueshëm me NUIS J81512003D

Selia: Bulevardi “Bajram Curri”, pallati. 114, kati i dytë, apartamenti 1, Tiranë, Shqipëri

Drejtor Ekzekutiv i Albautor: Z. Erlir PUTO

Licenca është e vlefshme për një periudhë 3 (tre) vjeçare.
Kjo licencë hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Licenca duhet të ekspozohet në zyrat e agjencisë

Mirela KUMBARO FURXHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
ZYRA SHQIPTARE PËR TË DREJTËN E AUTORIT

LIÇENCË

Nr 2 Dt 27.5 2015

Në mbështetje të ligjit Nr. 9380, dt 28.04.2005 "Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të", i ndryshuar, dhe V.K.M Nr. 232, datë 19.04.2006, Ministri i Kulturës, pasi konstatoi se dokumentacioni i paraqitur nga Agjensia "ALBAUTOR", është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi për të drejtat e autorit dhe të tjera të lidhura me të,

VENDOSI:

Të liçennojë subjektin "ALBAUTOR"
si Agjenci e Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Autorëve të veprave Artistikë dhe Letrare.

Njohur si person juridik me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr. 587, datë 18.02.1998, i ndryshuar

Person i tatueshëm me **NIPT: J81512003D**

Selia: Rr. Gjin Bue Shpata, nr. 3/2, Tiranë, Shqipëri.

Drejtor Ekzekutiv i ALBAUTOR : Z.Erlir PUTO

Liçenca është e vlefshme për një periudhë 3 (tri) vjeçare
Kjo liçencë hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Liçenca duhet të ekspozohet në zyrat e Agjensisë.

MINISTRI

Mirela KUMBARO FURXHI